



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË

PRANUAR MË:

PRILJENO

PRILJENO

19/08/2022

04/1315

Zyra e Personelit

Nr.01

Më: 19/08/2022

Në bazë të nenit 66 pika 2 e Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale Nr. 03/L-040, nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Komuna e Malishevës shpall:

Konkurs

Titulli i vendit të punës:	Roje e Pyllit
Institucioni:	Komuna e Malishevës
Departamenti/ Drejtoria:	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
Numri i pozitave:	(1) Një
Titulli i mbikëqyrësit:	Udhëheqësi i sektorit për Pylltari
Koeficienti:	4.5

- Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Merr detyra nga shefi i sektorit të pylltarisë dhe nga tekniku i pylltarisë
- Ruan pyjet nga prerja ilegale, nga zjarret dhe dëmtimet tjera.
- Ruan florën dhe faunën e pyjeve - bën vulosjen e drurëve të prerë
- Jep fletë përcjellëse për transportin e druve të vulosura dhe të prera legalisht
- Shkruan fletëparaqitje dhe i paditë në gjykatat përkatëse personat që bëjnë dëmtimin e pyllit
- I raporton teknikut për pylltari dhe udhëheqësit të pylltarisë
- Paraqet raporte pune mujore, periodike dhe vjetore
- Kryen edhe punë tjera të caktuara sipas kërkesës së eprorit që janë në pajtim me ligjin

- Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs janë:

Të drejtë konkurrimi në këtë pozitë kanë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Shkathtësitë e kërkuara (kualifikime, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend pune):

- **Shkolla e Mesme**

- Dokumentet:

- Diploma e shkollës së mesme
- Certifikata që nuk është nën hetime nga Gjykata
- Certifikata e mjekut - shëndetësore (pas shpalljes se rezultateve përfundimtare)
- Certifikata e lindjes
- Kopja e letërnjoftimit

Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartcekur duhet t'i komplettoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm (fotokopje) si vijon:

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** kalendarike nga data **19.08.2021** deri me **05.09.2021**.

- Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në zyrën për pritjen me qytetarë, kati I, objekti i ri i Komunës së Malishevës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të njoftohen për vendin, datën dhe kohën e mbajtjes së testimit me shkrim përmes tabelës së shpalljeve publike të Komunës së Malishevës.



Gani Bahtjaraj
Udhëheqësi i Personelit